

Vullnetarizmi në Kosovë

Viti Europian i Vullnetarizmit

2011

www.europa.eu/volunteering

Vullnetarizmi në Kosovë konceptohet si bamirësi...në diçka materiale si ndihma në të holla, ushqim ose veshmbathje... nuk konceptohet si pasojë e situatës që ka kaluar kjo është si pasojë e situatës që ka kaluar popullata në Kosovë, sidomos në periudhën '90-'99. Ne kemi kulturë të vullnetarizmit... nuk kemi vullnetarizëm të edukuar permanent... është diçka si reagim i çastit/momentit'.

Gani Lluga-Sociolog

'Vullnetarizmi na ka mbajtur gjallë. Ka qenë konteksti në të cilin është shfaqur vullnetarizmi në Kosovë ai që e ka bërë këtë punë të suksesshme. Kemi pasur një kërcënim të madh, kemi pasur frikë të madhe, kemi pasur nevojë që dikush të na përkrahte, sepse nuk mund të iknim që të gjithë nga Kosova – kush për shkak të patriotizmit e kush për shkak se nuk ka pasur mundësi. Ky lloj organizimi ad-hoc i dha mundësi shumëkujt që të inkuadrohej në këtë aktivitet dhe gjithashtu dha mundësi për zhvillimin e shkathtësive organizative.

Dha mundësi për kreativitet (ka qenë vërtetet kreative të fshiheshin materialet e Këshillit (KLMDNJ) e që të mos na i merrte policia) – ngase dihej qartë qëllimi i gjithë punës vullnetare: **mbijetesa**. Puna vullnetare rriti edhe përgjegjshmërinë e njerëzve, poashtu rriti interaktivitetin ndërmjet popullatës "elite" dhe asaj "të harruar"; bëri që shumica e vullnetarëve të njiheshin me Kosovën më ndryshe – dalja në terren jep pasqyrë reale të situatës që është shumë më ndryshe nga përshkrimet bukolike që u bëhen fshatrave në letërsinë kosovare'.

Flaka Surroi

Vullnetarizmi si koncept ka kuptime të ndryshme. Ekzistojnë shumë definicione rreth kuptimit të plotë dhe të mirëfilltë të tij, por nuk ka një definicion të përgjithshëm dhe të vetëm për te. E njëjta vlen edhe për njerëzit të cilët angazhohen në punë vullnetare, të cilët kanë arsye dhe motive të ndryshme përse ata zgjedhin të kontribuojnë me punën e tyre bamirëse në shoqëri. Një arsye, ndonëse tingëllon pak romantike, është se njerëzit me pak angazhim dhe punë vullnetare për shoqërinë, janë njerëz të cilët besojnë dhe thellësisht dëshirojnë që t'u bëjnë jetën më të lumtur njerëzve prej të cilëve rrethohen, dhe njëkohësisht botën ta bëjnë një vend më të mirë.

Sidoqoftë, një definicion më i përgjithshëm për vullnetarizmin thotë se **"Akti i të qenurit vullnetar është një shprehje e lirisë, duke reflektuar ndjeshmërinë për nevojat e të tjerëve dhe shpesh duke përfshirë sakrificën personale"**

Kur flasim për vullnetarizmin si koncept lokal, duhet të mirren parasysh shumë faktorë historik dhe periudha nëpër të cilën ka kaluar popullata e Kosovës. Për shkak të rrethanave dhe faktorëve historik, vullnetarizmi në kontekstin Kosovar shpesh është parë jo vetëm si bamirësi por edhe si mbijetese.



EU INFORMATION AND CULTURAL CENTRE



European Year of Volunteering 2011





Sipas Hulumtimit të fundit të Popullsisë dhe Hulumtimit të Organizatave - CIVICUS, Kosovë:

- Vetëm 11% e respondentëve (1300 respondentë) aktualisht janë përgjigjur se bëjnë punë vullnetare pa pagesë për ndonjë organizatë
- Më pak se 10% e respondentëve (1300 respondentë) kryejnë punë vullnetare për organizata humanitare dhe të bamirësë
- 48.5% e organizatave (100 organizata) janë përgjigjur se puna vullnetare ka rënë gjatë pesë viteve të fundit në përgjithësi
- 57% respondentëve (1300 respondentë) mendojnë se organizatat humanitare dhe të bamirësish kanë pasur ndikim në zhvillimin e përgjithshëm (gjatë pesë viteve të fundit)

Vullnetarizmi në Kosovë!

Njëra ndër shoqatat e para humanitare në Kosovë është Shoqata Humanitare Bamirëse 'Nëna Terezë'. 'Nëna Terezë' është themeluar në Maj të vitit 1990, nga një grup intelektualësh të njohur të asaj kohe, të cilët si rezultat i situatës shumë të rëndë socio-ekonomike dhe politike në Kosovë, vendosën të bashkohen për të ndihmuar dhe për t'i dalë zot dinjitetit njerëzor.

Kjo shoqatë kryesisht u fokusua në ofrimin e ndihmës për familjet në nevojë, kontribuoj shumë poashtu në shëndetësi, arsim dhe edukim përmes aktiviteve të shumëta. Numri i personave që në një mënyrë ose tjetër u përkrahën nga kjo shoqatë është i madh. Në vitin 1990 ishin 174,000 persona; në vitin 1997 numri arrin në 389,000, ndërsa në vitin 1999 në 721,000 persona. Poashtu, gjatë kësaj periudhe kjo shoqatë kishte hapur 104 ambulanta, ndërsa në vitin 1997 hapi edhe maternitetin e parë në Prishtinë ku linden 13,000 fëmijë dhe u kryen 800 ndërhyrje kirurgjikale. Edhe gjatë viteve 1999-2002 kjo shoqatë vazhdoi punën, ku aktivistët e kësaj shoqate ishin pjesë e popullit dhe ndanin me ta brengat dhe mundimet. Numri i përfituesve arrinë në 1,260,000, ndërsa në vitin 2002 ky numër ra në 231,000 përfitues. Sot, pas më shumë se 20 vite të ekzistencës, shoqata ka 4,200 vullnetarë të regjistruar krahasuar me 7,200 që dikur i kishte të regjistruar dhe aktiv.

Nëna Terezë

Vullnetarizmi që nga 1990

www.motherteresasociety.org

A ekziston ligji mbi vullnetarizmin në Kosovë?

Ligji dhe Vullnetarizmi

Çka ofron korniza ligjore ekzistuese për vullnetarizmin në Kosovë?

Aktualisht, në Kosovë çështja e vullnetarizmit rregullohet pjesërisht me **'Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë'**. Ka shumë zëra se ky ligj është i pamjaftueshëm dhe nuk rregullon çështjen e vullnetarizmit në nivel vendi.

'Sa i përket infrastrukturës ligjore për vullnetarizmin, puna vullnetare sa i përket rinisë është e përfshirë në 'Ligjin për përfshirjen e rinisë', por kjo nuk vlen edhe për punën vullnetare të grupmoshave tjera. Në Kosovë ende nuk ka ligj që rregullon këtë çështje, andaj do të duhej që kjo çështje të rregullohet në nivel vendi dhe të hartohet Ligji mbi Vullnetarizmin, ku do të definohehin këto gjana për të gjitha grupmoshat, si dhe principet dhe gjanat tjera që lidhen me aktivitetet vullnetare'

Fatmir Hoxha (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit)

'Nuk besoj se ekziston infrastrukturë e mirëfilltë as ligjore e as shoqërore për zhvillimin e vullnetarizmit. Nuk ekziston as më e vogla tentativë e institucioneve shtetërore që ta inkurajojnë zhvillimin e vullnetarizmit në kuptimin e dhënies së lehtësirave fiskale pwr ndërmarrjet e mëdha që do të mund të kontribuonin për realizimin e një qëllimi vullnetar. Sepse, sado që njerëzit do të ishin të gatshëm të ndërmarrim veprimtari vullnetare, këtë nuk mund ta bëjnë pa para në kuptimin e përkrahjes së punës.'

Flaka Surroi

E lindur dhe e rritur në Prishtinë, Mrika Aliu-një vullnetare/aktiviste e dalluar mund të jetë një ndër shembujt më të mirë se si të rinjtë e Kosovës mund të plotësojnë veten dhe t'i shërbejnë komunitetit. Ka mbaruar studimet në Universitetin Amerikan të Kosovës, ku edhe aktualisht punon. Në janar të viti 2010, ka themeluar Klubin e Bamirësisë në kuadër të AUK-ut. Aktualisht, ky klub ka 80 vullnetarë, kryesisht studentë të cilët kryejnë shërbime/punë vullnetare për komunitetin si: ndihmë familjeve të varfëra, studentëve, të moshuarve, njerëzve me nevoja të veçanta, jetimëve dhe minoriteteve në Kosovë. Për punën e madhe që ka bërë, këtij klubi poashtu i janë ndarë disa çmime siq janë: 'Alpha Sigma Lambda Honorary Society Award' dhe 'AUK Community Service Leadership Award'. Klubi edhe më tutje është funksional dhe po vazhdon me aktivitete të ndryshme vullnetare, së bashku me Mirkën e cila shprehet 'Puna vullnetare që bëjë për komunitetin më përmbushë, më bën më të plotë. Vullnetarizmi të jep mundësinë për të ndryshuar gjërat, për të ndryshuar jetën. Unë e bëjë këtë për të promovuar të mirën, për të ndikuar sadopak në përmirësim e cilësisë së jetës së njeriut, dhe për të promovuar vlerat njerëzore. Sepse, dikush ka thënë se nuk ka asgjë më të fortë se zemra e një vullnetari. Dhe unë jam e bindur se njerëzit që bëjnë punë vullnetare janë të përkushtuar për të sjellur ndryshime pozitive'.



Mrika Aliu

Albion Zeka



'Puna vullnetare më rriti, dhe më bëri ky që jam sot. Angazhimi im i vazhdueshëm në aktivitete dhe punë vullnetare, ka qenë eksperiencë shumë e mirë, e dobishme dhe më ka ndihmuar në rrugën për tu kyqur në nivele tjera'. Angazhimi i parë i tij si vullnetar ishte për Këshillin Rinor Shqiptar, diku në vitin 1999, kur si refugjatë po qëndronte në Shqipëri. Pas kthimit, në Kosovë ai vazhdon angazhimin e tij në shumë aktivitete dhe organizata të ndryshme. Fillimisht, me aktivitete për fëmijët në Gjakovë, për të vazhduar më vonë edhe me aktivitete tjera si shkrim të projekt-propozimeve, ofrimin e kurseve të gjuhës, fushata vetdijësuese, pastrimi e shumë tjera. Më vonë, së bashku me 20-30 të rinjë të Gjakovës themelon organizatën 'Fare Verde', për tu bërë më vonë pjesë e themeluesve dhe antarësisë së Rrjetit Rinor të Kosovës (i themeluar në 2001). Mëpastaj, Albioni për 6-7 vite me radhë angazhohet intensivisht dhe punon si një ndër udhëheqësit e këtij rrjeti dhe poashtu për 3 vite ishte zgjedhur Nënkretar i Rrjetit Rinor Kosovar si dhe Kryetar i këtij rrjeti për rreth 6 muaj. Pas kësaj eksperience filloj të punoj për disa nga organizatat ndërkombëtare si UNDP, OSCE, AED etj. Aktualisht, Albioni është i angazhuar si Ekspert Lokal në organizatën ndërkombëtare GIZ në Prishtinë.

'Në fillim me thënë të drejtën nuk kam hyrë në punë vullnetare se kam dashur, mirëpo nuk kam pasur ndonjë punë e cila më ka sjellur përfitime materiale andaj kam filluar të bëj punë vullnetare. Gjatë kësaj pune unë kam ndjerë në vetën time se unë paskam mundësi të ndjehem i rëndësishëm dhe t'i ndihmoj zhvillimit të komunitetit ku jetoj, por në të njejtën kohë të mësoj nga përvoja. Unë kam bërë shumë punë vullnetare. Por, tani më kujtohet një aktivitet i cili tashmë është bërë tradicional. Është viti i pestë që unë së bashku me KFOR-in Amerikan për festat e fundvitit shpërndajmë dhuratat për fëmijët që kanë nevojë. Gjithashtu ka shumë ditë tjera të shënuara, ku unë së bashku me shokë dhe kolegë kemi organizuar aktivitete të ndryshme për ti shënuar këto ditë siq janë: Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit; Dita Ndërkombëtare e Rinisë, Dita Ndërkombëtare kundër HIV-AIDS-sit, Dita Ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara, Dita e Rinisë (Gjilan), Dita e Tokës, 11 Shtatori etj. Pas shumë angazhimeve të ndryshme në punë dhe aktivitete vullnetare në organizata të ndryshme, tani Burimi është i punësuar si Menaxher i Programit për Zhvillim të Biznesit në kuadër të KPEP/USAID.



Burim Korça

Bardha Uka



Në vitin 2008, një shok i imi më ka ftuar të marrë pjesë në një cikël trajnimesh rreth "Qeverisjes lokale", në kohën kur unë isha në vitin e parë të shkollës së mesme. Falë angazhimit dhe pjesëmarrjes në këto trajnime të cilat kanë qenë të organizuara nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC), Bardha merr ftesën për tu angazhuar edhe si vullnetare e kësaj organizate. Sipas Bardhës, këta ishin edhe hapat e parë të cilët e bënë që t'a kuptoj më mirë rolin e saj dhe kontributin që mund të jap për shoqërinë. Ishte pikërisht kjo organizatë dhe puna vullnetare që i ndihmuan asaj për të fituar shprehitë e punës por edhe për tu socializuar dhe takuar shumë të rinjë dhe zyrtarë tjerë nga qytete të ndryshme me të cilat kanë shkëmbyer ide dhe përvoja të ndryshme. Tani, pas dy vite pune vullnetare, Bardha ende vazhdon angazhimin e saj në këtë organizatë, por tani si menaxhere e projektit.

Aktivitete:

Çka Tryezë Diskutimi dhe Foto Ekspozitë

Kur: 17 Nëntor, 2011 (E Enjte) - Ora: 11:00

Ku: QENDRA INFORMATIVE DHE KULTURORE E BE-së

www.euicc-ks.com

Përmbledhje

- Definicioni dhe të kuptuarit e vullnetarizmit ndryshon; ekzistojnë shumë definicione por jo ndonjë definicion i përgjithshëm.
- Një nga definicionet e përgjithshme thotë se 'Vullnetarizmi është vendimi për të vepruar sipas nevojës, me përgjegjësi shoqërore dhe pa menduar në përfitim financiar, duke shkuar përtej obligimeve personale.' (By the People: A History of Americans as Volunteers by Susan J. Ellis and Katherine H. Campbell).
- Vullnetari në anën tjetër është 'Dikush që shpenzon kohë, mund dhe talent për një çështje ose kauzë pa përfitim financiar.' (Susan J. Ellis, Energize Inc)
- Ekzistojnë shumë arsye pse njerëzit zgjedhin të bëhen vullnetar. Arsyet kryesore janë: për ti ndihmuar të tjerët, për të kontribuar për një kauzë dhe për të përmirësuar jetën e të tjerëve.
- Vullnetarizmi ofron mundësi për të mësuar, si dhe angazhimi në punë vullnetare mund t'ju ofroj njerëzve shkathtësi dhe përgjegjësi të reja, që rrisin mundësitë e tyre për punësim.
- Vullnetarizmi luan rol të rëndësishëm në sektorë të ndryshëm siq është edukimi, rinia, kultura, sporti, ambienti, shëndeti, kujdesi social, mbrojtja e konsumatorit, ndihma humanitare, politika të zhvillimit, hulumtime, mundësi të barabarta dhe marrëdhënie me jashtë.
- Në Bashkimin Europian, përafërsisht 100 milion qytetarë të të gjitha grupmoshave investojnë kohën, talentin dhe paratë e tyre për të kontribuar pozitivisht për komunitetin në organizata të shoqërisë civile, klube të rinjve, spitale, shkolla, klube të sportit dhe të ngjajshme.

Informata për VEV 2011

- Viti 2011 është njohur botërisht si Viti European i Vullnetarizmit, një iniciativë që synon të jetë në të njëjtën kohë festë dhe sfidë.
- Shtetet e BE-së kanë bërë turne për më shumë se një vit, duke ndaluar në secilin Shtet Anëtar për 10 ditë për të festuar angazhimin e vullnetarëve duke iu dhënë atyre mundësinë të ekspozojnë punën e tyre, të takohen me njëri-tjetrin, të angazhohen me krijuesit e politikave dhe të diskutojnë çështjet kyçe për të ardhmen e punës së tyre.
- Përveç projekteve të ndryshme, një nga mesazhet më të rëndësishme të Vitit European të Vullnetarizmit 2011 është se përpjekjet e vullnetarëve dhe të mijëra orgnizatave të vullnetarëve bëjnë një ndryshim të madh në jetën e njerëzve në mënyra të ndryshme.
- VEV 2011 ofron mundësi dhe inkurajon idetë e njerëzve të cilët dëshirojnë të bëjnë punë vullnetare për kauza të veçanta në të cilat besojnë. Bota do të ishte shumë më keq pa vullnetarë.

